

MANJOLA BREGASI

**MESAZHET ELEKTRONIKE SI SHPREHJE E EKONOMISË
GJUHËSORE DHE TENDENCA E TYRE TEK TË RINJTË**

Abstrakt

Komunikimi përmes mesazheve të shkruara, pasqyron së fundmi një rritje të dukshme të përdorimit të shkurtimeve dhe shkurtesave, e shfaqur në mënyrë të ndjeshme veçanërisht tek të rinjtë. Përdorimi i këtyre mesazheve është i lidhur ngushtësisht dhe në mënyrë të qartë me ligjin e ekonomisë gjuhësore, me synimin për të dhënë sa më shumë informacion, me sa më pak mund dhe sforco. Njëkohësisht nevoja për ta dhënë sa më shpejt këtë informacion, pra për të fituar kohë në këtë komunikim, është një tjetër element që i vjen në ndihmë ligjit të ekonomisë gjuhësore dhe nxit përdorimin e gjuhës së shkurtesave. Nga ana tjetër, duket se në komunikimin e mesazheve telefonike, këtë gjuhë e ka kushtëzuar edhe numri i përcaktuar i karaktereve të vëna në dispozicion të përdoruesit, duke na ofruar shembuj të pafund të komunikimit, ku fjalët e plota janë zëvendësuar me shkurtime fjalësh e madje edhe me ikona e simbole. Të rinjtë, në raport me të gjitha grupmoshat e tjera, janë ata që po përqafojnë gjithmonë e më shumë teknologjinë e si rezultat janë ata që po përdorin gjithnjë e më tepër këtë lloj komunikimi.

Fjalë kyçe: Emërtime të shkurtuara, ekonomi gjuhësore, mesazhe.

Hyrje

Në një shoqëri globaliste e cila gjithmonë e më tepër po synon të shkojë drejt afrimit, përgjithësimit, shkrirjes së kufijve dhe ekonomizimit të kostove, duket se edhe gjuha nuk bën përjashtim. Këtë prirje globaliste po e nxit edhe zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë, krijimi i hapësirave të pafundme të komunikimit përmes mjeteve që teknologjia ofron, heqja e kufijve dhe lëvizja e lirë e individëve. Gjuha nga ana e saj i pasqyron të gjitha këto sjellje dhe dukuri njerëzore duke shfaqur njëkohësisht edhe ndryshimet e veta, shpesh në përputhje me këto zhvillime, të cilat e prekin gjuhën në mënyra të ndryshme duke i sjellë asaj pasurim me fjalë të reja, shprehje e mjete të reja gjuhësore, por njëkohësisht edhe ndryshime e transformime të cilat sjellin efekte të dykrahshme, dikur pozitive e diku negative. Sikurse e thamë në fillim, prirja për ekonomizim është një shfaqje e dukshme e zhvillimeve shoqërore të pasqyruara në gjuhë. Në fakt arsyet e sipërpërmendura, nuk janë të vetmet që përcaktojnë ekzistencën dhe nevojën për ekonomi gjuhësore, por nga ana tjetër janë dominuese mbi faktin, që kjo dukuri të paktën nga pikëpamja leksikologjike shfaqet në gjuhë të ndryshme në forma të ngjashme. Nga ana tjetër, zhvillimi i vazhdueshëm i teknologjisë ka shfaqur ndikimin e tij thuajse

në të gjitha fushat e jetës. Zëvendësimi i telefonave të thjeshtë me smart phone, zëvendësimi i kompjuterave apo laptopëve me tabletat e avancuara, veçanërisht tek të rinjtë po lë gjurmët e veta edhe në gjuhë, si mjet komunikimi me këto pajisje teknologjike. Një nga shfaqjet e qarta të këtij ndikimi është fakti, që komunikimi në bisedat telefonike është zëvendësuar në komunikimin përmes mesazheve elektronike, whatsapp apo edhe komunikimin përmes rrjeteve sociale. Pra gjuha e folur është zëvendësuar nga gjuha e shkruar, e cila e ardhur përmes mesazheve elektronike, vitet e fundit ka shfaqur ndryshime dhe zhvillime mjaft interesante. Këto zhvillime, të cilat në thelbin e tyre kanë ligjin e ekonomisë gjuhësore, vërehen në mënyrë të veçantë tek të rinjtë dhe kryesisht tek adoleshentët, të cilët janë jo vetëm përdoruesit dhe konsumatorët kryesorë të teknologjisë, por njëkohësisht janë ata që e përqafojnë më shpejt të renë. Nga ana tjetër kjo tendencë e përdorimit të mesazheve elektronike ka sjellë një shmangie të dukshme nga norma, pikërisht tek ky target grup, që duket se janë edhe më të pakujdesshëm në këtë drejtim. Ky punim do të prezantojë pikërisht disa shfaqje të ligjit të ekonomisë gjuhësore në komunikimin virtual përmes mesazheve elektronike tek shqipfolësit. Metodologjia e përdorur në këtë punim është ajo e anketimit, intervistimit, analizimit dhe e krahasimit të përgjigjeve të dhëna nga të rinjtë, në raport me mosha më të rritura.

Ligji i ekonomisë gjuhësore si koncept

Një term tashmë prezent dhe i pranuar i gjuhësisë, ligji i ekonomisë gjuhësore, ka në thelb të kuptimit të tij, ekonominë. Nga pikëpamja leksikore dhe etimologjike, fjala ekonomi në një kuptim të përgjithshëm do të thotë: fitim, kursim, më pak ngarkesë, më pak mund. Në Fjalorin e shqipes se sotme 1984 një nga kuptimet e fjalës ekonomi është: rregull ose masë në shpenzim, kursim, p.sh. përdor me ekonomi. Një tjetër kuptim i kësaj fjale po në këtë fjalor është: që të jep mundësinë të ruash, që nuk shpenzon¹. Pra në këtë pikëpamje, fjala ekonomi na sjell në parimin e kursimit, të ruajtjes së diçkaje. Një kuptim të ngjashëm i jep këtij termi edhe fjalori i studentëve të Oksfordit të vitit 1988, ku fjala ekonomi shpjegohet si një sistem i kontrollit dhe menaxhimit të parave, të mirave materiale apo edhe burimeve të tjera të një komuniteti apo mbajtjes së një shtëpie². Mbështetur në këtë bazë kuptimore, të menaxhimit dhe të kursimit termi ka gjetur përdorim edhe në fusha të tjera të karakterit social apo lingvistik. Sikurse njihet, është padyshim Andre Martinet themeluesi dhe zhvilluesi i konceptit të ekonomisë në lingvistikë, mbështetur në parimin sa më pak mund të sforco. Sipas Martinesë, “zhvillimi gjuhësor mund të konceptohet si i drejtuar nga kontradikta e përhershme midis nevojave komunikuese të njeriut dhe prirjes së tij për ta rrudhur në minimum

¹ Shih *Fjalori i Shqipes së Sotme*, Tiranë, 1984, f. 256.

² Shih *Oxford Student's Dictionary*, Oxford, 1988, f. 201.

veprimin mendor dhe fizik”³. Natyrisht kjo rrudhje e veprimit mendor nuk duhet të sjellë cenim në përmbushjen e qëllimit, që në këtë rast është komunikimi. Por nëse Martinesë i atribuohen pa diskutim vlerat e zhvillimit dhe përpunimit të teorisë mbi parimin e ekonomisë në gjuhë, duket se përpara tij të tjerë shkencëtarë kanë folur dhe shkruar mbi këtë parim, jo vetëm në fushat gjuhësore, por edhe në disiplina të tjera. Dhe është pikërisht George Kingsley Zipf, në teorinë e të cilit parimi i ekonomizimit luan një rol të rëndësishëm balancues: çdo ndryshim jo ekonomizues që do të sjellë një kosto të rritur të termave të përdorura dhe përpjekjeve të bëra duke krijuar një pengesë në komunikimin, në mënyrë automatike do të mënjanohet ose do të largohet⁴. Duke e trajtuar ligjërimin si një fenomen natyral Zipf, bëri të ditur se ekonomia është një kriter rregullues në çdo aspekt të qenies njerëzore që udhëhiqet nga parimi me sa më pak mund, i cili vepron gjithashtu edhe në gjuhësi⁵. Parë në këtë këndvështrim përdoruesit e gjuhës janë të prirur të ekonomizojnë mjetet e saj për të realizuar komunikimin, duke u drejtuar nga ligji që Martine e quajti: sa më pak mund për një qëllim të caktuar.

Emërtimet e shkurtuara si shfaqje e ligjit të ekonomisë gjuhësore dhe përdorimi i tyre tek mesazhet elektronike

Sikurse u përmend më sipër, në bazë të ligjit të ekonomisë gjuhësore qëndron tendenca për të shpenzuar sa më pak mund dhe sforco për të shprehur informacionin, duke kursyer në këtë mënyrë edhe hapësirë e kohë. Duket se emërtimet e shkurtuara e përmbushin më së miri këtë funksion dhe qëllimi i krijimit të tyre është i lidhur në mënyrë primare me ekonominë gjuhësore. Mesazhet elektronike, nga ana tjetër tentojnë të japin informacionin përmes germave të tastierës dhe hapësirës që celulari ofron. Duke përdorur gjuhën e shkurtimeve, të rinjtë tentojnë që informacionin ta japin sa më shpejt e nga ana tjetër me sa më pak mund, por njëkohësisht duke kursyer hapësirë. Të gjithë këta elementë të marrë së bashku cojnë drejt përdorimit të emërtimeve të shkurtuara. Po deri ku shkon kufiri i përdorimit të këtyre njësive, pa cenuar vetë informacionin?

Sikurse kemi parë edhe në punime të mëparshme tonat, e njëkohësisht duke iu referuar punimit, mbi “Emërtimet e shkurtuara në gjuhën shqipe”,⁶ ne kemi rënë dakord që me termin emërtime të shkurtuara, si një hiperonim, një term gjithëpërfshirës, do të përmbledhim shkurtime dhe shkurtesat. Shkurtime si përfundim procesi, por edhe si terminologji emërtuese do t’i

³ A. Martinet, *Elementë të gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 2002, f. 149.

⁴ George Kingsley Zipf, *Human Behavior and the Principle of Least Effort: An Introduction to Human Ecology*, Addison-Wesley Press, 1949, f. 221.

⁵ George Kingsley Zipf, *Human Behavior and the Principle of Least Effort: An Introduction to Human Ecology*, vep. cit. f. 221

⁶ V. Memisha & M. Bregasi, *Emërtimet e shkurtuara në shqipe*, Vlorë, 2008, f. 8.

kërkojmë përgjithësisht te format e shkurtuara brenda një fjale, duke i dalluar nga shkurtesat që janë formime nga rrokje, shkronja a tinguj nistorë të emërtimeve togfjalëshore.⁷ Ndërkohë, emërtimet e shkurtuara të përdorura në mesazhet elektronike duket se i kalojnë kufijtë e të dy rasteve. Çfarë janë në fakt këto njësi?

Sikurse përmendëm më sipër, ne biem dakord për të përdorur termin emërtime të shkurtuara për të gjitha njësitë e shkurtuara të përdorura në gjuhën elektronike. Por ndryshe nga shkurtime dhe shkurtesat e njohura deri tani, të krijuara kryesisht sipas një parimi të gjuhës shqipe, duket se këto njësi, nuk ndjekin parime apo rregulla.

Studiuesja Drita Garuci është marrë drejtpërdrejt me emërtimet e shkurtuara dhe shkurtesat. Ajo parashtrohet se “Shkurtime bazohen në faktin se për komunikimin e shpejtë në fjali ka shkronja, heqja e pjesshme e të cilave nuk pengon perceptimin e plotë të fjalëve.⁸ Po a ndodh i njëjti fenomen me emërtimet e shkurtuara të përdorura në mesazhet elektronike. Le të shohim disa shembuj e të analizojmë mënyrën e formimit dhe sjelljen e tyre në gjuhë:

Denisi te mori per dje, Coji msg per leket.

Epo po qe kshu nuk punohet nsr.

Tn sa me tha... qe i ka bere mszh nga ora 3 dhe nuk i ka kthy prgj.

Nuk mu përgj. A ke fol?

Jam sh më mirë sot.

Shumë flm për interesimin.

Po e përdor tel tim gjithë kohën.

Në një pjesë të mesazheve të sipërshënuara vihet re se ka një parim të krijimit të emërtimeve të shkurtuara mbështetur mbi disa gjethe shkurtime të përdorura në shqip. Kështu shohim shkurtime të fjalëve telefon - tel apo përgjigj - përgj të ngjashme me shkurtime të fjalëve profesor- prof. apo inxhinier - ing, me rënie të tingujve fundorë. Kemi gjithashtu shkurtime të fjalës shumë – sh, gjithashtu me rënie të tingujve fundorë duke ruajtur vetëm fonemën e parë, e ngjashme me mënyrën e shkurtimeve të njësisë matëse p.sh., metër - m, litër – l, etj. Por në mesazhet e sipërshënuara vihen re edhe disa emërtime të shkurtuara të tipit tn - tani, mszh - mesazh, nsr - neso, prgj - përgjigje etj. Këto njësi të shkurtuara, ndonëse në pamje të parë mund të duket se janë analoge me emërtimet e shkurtuara si tek fjalët doktor - dr, kilogramë - kg, centimetër-cm dhe janë krijuar me anë të rënies së disa tingujve në trup të fjalës, në të vërtetë janë krijime krejt rastësore të lindura momentalisht për qëllime pragmatiste të folësit dhe pa asnjë bazë gjuhësore. Ajo që bie në sy në këto emërtime të shkurtuara, është rënia e zanoreve dhe mbetja e thujse të

⁷ V. Memisha & M. Bregasi, *Emërtimet e shkurtuara në shqip*, vep. cit. f. 25.

⁸ D. Garuci, *Mbi drejtshkrimin e shkurtimeve*, “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”, Tiranë, 1973, f. 476.

gjitha bashkëtingëlloreve të fjalës. Këto krijime të reja, të cilat kryesisht funksionojnë si të tilla vetëm në gjuhën e shkruar (ndonëse në një punim tjetër ne kemi parë edhe tendencën e tyre për të hyrë në gjuhën e folur) duket se për momentin janë dominante në zhargonin e të rinjve. Këto njësi nuk përmbushin asnjë kriter për t'u cilësuar njësi leksikore apo fjalë, megjithatë janë pjesë e komunikimit. Çështja është sa realizon ky lloj komunikimi qëllimin e tij nga njëra anë dhe çfarë ndikimi kanë këto njësi në gjuhë?

Shembujt e mëposhtëm janë shkëputur nga mesazhet telefonike tek 5 të rinj, të moshës 16- 23 vjeç.

Denisi te mori per dje, Coji msg per leket.

Epo po qe kshu nuk punohet nsr.

Tn sa me tha... qe i ka bere mszh nga ora 3 dhe nuk i ka kthy prgj.

Nuk mu përgj. A ke fol?

Jam sh më mirë sot.

Shumë flm për interesimin.

Po e përdor tel tim gjithë kohën.

Ma gjej nr e Marios pls.

Pse pyt kaq shumë x mua.

Njs e di qe une jam gabim, por ky jam une.

Ma dergo nr e Jarit tlt

Pa prob.

Per 20 min lirohem.

m.mëngjes shoqe.

Flsm nsr në zyrë.

M thuj me mszh.

Epo shyqyr që nk je lodh. Ok pra, kshu e lm per nsr. Flsm në m.gjes. natën.

Ja sa të bëj një tel ajo. Megj ti zbrit dhe takohemi bashkë.

Pasi janë marrë këto mesazhe dhe u janë treguar disa personave mbi moshën 50-vjeçare është vënë re që ata, jo vetëm që nuk e përdorin këtë gjuhë, por në disa raste e kanë pasur të vështirë identifikimin e fjalëve. Ndërkohë, mes të rinjve që komunikojnë përmes këtyre mesazheve duket se nuk ka asnjë problem të identifikimit të fjalëve që këto emërtime të shkurtuara përfaqësojnë, pra komunikimi realizohet. Sikurse profesor Gjovalin Shkurtaj shkruan tek “Sociolinguistika e Shqipes”, të rinjtë janë më përtëritës (inovativë) kurse të vjetrit janë më konservatorë.⁹ Me sa duket ky fenomen është i pranishëm edhe në këtë rast duke na e bërë më të qartë arsyen e shpeshtisë së këtyre njësive në gjuhën e të rinjve. Duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me teknologjinë dhe përdorues më të gjerë të saj, janë pikërisht të rinjtë ata që për të rritur shpejtësinë e komunikimit nga njëra anë dhe për të shfrytëzuar hapësirën në anën tjetër i drejtohen gjuhës së shkurtimeve.

⁹ Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2009, f. 118.

Njëkohësisht ky target grup është më i ndikuar edhe nga gjuhët e tjera, tek të cilat në fakt ky lloj komunikimi është i pranishëm duke arritur madje edhe në simbole (të cilat nuk i kemi prekur në këtë punim). Nga ana tjetër përballë këtyre tendencave qëndron brezi i vjetër, si më i pandikuar nga prirjet moderniste, që në rastin konkret pengohen edhe nga mospërdorimi i dendur i teknologjisë në këto grupmosha. Më poshtë po japim disa shembujsh emërtime të shkurtuara të përdorura në komunikimin e të rinjve.

Klm – kalofsh mire

Msg-mesazh

Nsr- nesar

Kshu- kështu

Tn- tani

Mszh- mesazh

Prgj – Përgjigje

Flm- faleminderit

Pls- please

X- per

Njs- nejse

Tlt – Te lutem

Pa prob- pa problem

Min- minuta

M.mëngjes, gjes, m.gjes- mirëmëngjes

Flsm - flasim

Megj- megjithate

Vtm- Vetëm

Puc- puth

Pacim- pafshim- mirë u pafshim

Përfundime

Emërtimet e shkurtuara janë sot pjesë e komunikimit tonë verbal apo edhe e gjuhës së shkruar, nxitur edhe nga hapja e shoqërisë dhe zhvillimi i teknologjisë. Në këtë punim u përpoqëm të shihnim emërtimet e shkurtuara të përdorura kryesisht nga të rinjtë në komunikimet elektronike përmes mesazheve. Këto emërtime i përkasin më shumë gjuhës së shkruar, ndonëse për disa prej tyre tendenca është vërejtur për të hyrë edhe në gjuhën e folur, kryesisht me qëllime të caktuara stilistikore nga ky target grup. Sikurse u pa në këtë punim, këto njësi të krijuara kryesisht për qëllime pragmatiste, shpesh të ndikuara edhe nga gjuhë të huaja, janë të pashmangshme dhe një realitet, por nga ana tjetër në disa raste janë kërcënim për gjuhën duke qenë se krijohen në mënyrë të pakontrolluar duke u kthyer kështu në një trend. Kryesisht qëllimi i krijimit të tyre është i mbështetur tek ekonomia gjuhësore, nxitur nga zhvillimi i teknologjisë që e kushtëzon deri diku këtë komunikim.